

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Rep. 988 Nr.

Kol. 873 Nr.



KONTRATE PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE

Sot me 7 maj 2019, në Tiranë, përpara meje, Noteres MIMOZA Sadushaj, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, Shqiperi, ishin te pranishme palet si me poshte, te cilet nenshkruan kontraten qe vijon:

1. **Z. Spiro Kote**, shtetas shqiptar, lindur ne Vlorë (Shqiperi) më 16.04.1948, mbajtes i kartës së identitetit nr. 030105680, me nr. Personal 030105680, nr. BC9189662, zotërues i 87 aksioneve (tetëdhjetëeshtatë) te zakonshme, baraz me 1,45% (një presje dyzetëepesë perqind) te kapitalit aksionar te shoqerise shqiptare **Botimet Enciklopedike Sh.a.**, nje shoqeri aksionare e regjistruar prane Qendres Kombetar te Regjistrimit me **NIPT J61807025P**, me seli te regjistruar ne adresen Rruga Muhamet Gjollësha, Tiranë, Shqiperi (“**Shoqëria**”);
(ne vijim referuar si “**Shitësi**”)

dhe

2. **Znj. Ajola Xoxa**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë (Shqipëri), më 16.07.1983, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me numër 028669420, gjithashtu aksionare e Shoqërisë.
(ne vijim referuar si “**Blerësi**”).


(Shitësi dhe Blerësi ne vijim referuar, bashkerisht dhe veçmas, si “**Palet**” ose “**Pale**”).

MEQENESE:

- I. Shitësi dëshiron të shesë tek Blerësi të gjitha aksionet e Shoqërisë në pronësi të tij, pra 87 (tetëdhjetë e shtatë) aksione, me vlerë totale nominale 87.000 leke (tetëdhjetë e shtatë mijë lekë), per te gjitha aksionet ne pronësi te tij;
- II. Blerësi dëshiron t'i blejë 87 aksionet e Shoqërisë në pronësi të Shitesit (“**Aksionet**”), me çmimin 140'000 lekë (një qind e dyzetë mijë lekë) (“**Cmimi**”);
- III. Aksionet mund të transferohen lirisht mes aksionarëve të Shoqërisë.

NE BAZE TE SA ME SIPER, Palet bien dakord si vijon:

1. Ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj Kontrate, Shitesit do te transferoje tek Bleresit dhe Bleresit pranon nga Shitesit Aksionet dhe te gjitha te drejtat qe lidhen me Aksionet.
2. Me nënshkrimin e saj, kjo Kontrate do te regjistrohet brenda 72 (shtatedhjete e dy) oreve prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (“**QKR**”).

- 
3. Titulli i pronesisë mbi Aksionet do të transferohet nga Shitesi tek Bleresi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pagesën e Cmimit, e cila gjithashtu do të kryhet menjëherë, në prani të Palëve dhe Noterit.
 4. Çmimi, i barabartë me 140'000 (njëqind e dyzetë mijë) lekë, do të paguhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, dhe Shitësi, përmes nënshkrimit të kësaj Kontrate, deklaron se e ka marrë të gjithë Çmimin, dhe nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm.
 5. Shitësi deklaron se nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm mbi Aksionet apo Shoqërinë, dhe se nga ky moment e tutje heq dorë nga cdo e drejtë që ka të bëjë me Aksionet apo Shoqërinë.
 6. Shitësi ose Blerësi, ose një person i autorizuar prej njërit prej tyre, mund të paraqitet pranë QKB-së (Qendra Kombëtare e Biznesit) për të regjistruar transferimin e aksioneve nga Shitësi tek Blerësi.
 7. Kjo Kontrate do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
 8. Kjo Kontrate përben marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson cdo marrëveshje të mëparshme midis Palëve që lidhet me objektin e kësaj Kontrate.

Kjo Kontrate in lexua Paleve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, dhe u firmos përpara meje, dhe une Noterja e vertetoj atë sipas ligjit. Në përputhje me Ligjin Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterine", i ndryshuar, komunikimi me palën e huaj u bë në gjuhën angleze, në prani të përkthyeses Znj. Kozeta Speci, e njohur personalisht nga une.

PALET

SHITESI

Spiro Kote

Spiro Kote

Spiro Kote



BLERESI

Ajola Xoxa

Ajola Xoxa

NOTERE



Mimoza Sadushaj

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20190507172610307
Data e Rezultatit të Kerkimit: 07.05.2019
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 5:26:10PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-219-591
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

SPIRO NDREKO KOTE
BOTIMET ENCIKLOPEDIKE SH.A.

